

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TERMAT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE NGA OFRUESI I SHËRBIMIT POSTAR MILSPED ALBANIA SH.P.K.

Këto kushte të përgjithshme dhe terma të ofrimit të shërbimeve postare (këtu e në vijim referuar si "Kushtet") janë hartuar në mbështetje të nenit 32 të ligjit 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë" dhe në Autorizimin Individual të miratuar nga AKEP për Milsped Albania Shpk (këtu e në vijim referuar si "Operatori").

Neni 1 - Zonat ku ofrohen Shërbimet

1.1 Operatori operon në Bashkinë Tiranë (Shqipëri) dhe i ka zyrat postare në adresat e mëposhtme:

- a) Qemal Stafa Street, Pazari I Ri. Nr 74, 1-st tower, 2-nd floor, Tirana.]
- b) Gryka e Kacanikut godina Logjistic Parkut Autostrada Tirane – Duress , km 5, 1000

1.2 Operatori ofron shërbimet postare, që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar në zonat e përcaktuara më poshtë:

A. Shërbime postare që ofrohen brenda vendit

- a) Shërbim postar ekspres brenda vendit
- b) Shërbim jouniversal postar brenda vendit

Këto shërbime ofrohen brenda territorit si më poshtë:

- (i) Zona gjeografike e dërguesit: Bashkia Tiranë (Shqipëri).
- (ii) Zona gjeografike e marrësit: në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

B. Shërbime Postare me jashtë vendit

- a) Shërbim postar ekspres me jashtë vendit
- b) Shërbim jouniversal postar me jashtë vendit.

Këto shërbime ofrohen brenda territorit si më poshtë:



- (i) Zona gjeografike e dërguesit: Bashkia Tirane (Shqipëri).
- (ii) Zona gjeografike e marrësit: Në shtetin e Shqiperise.

Neni 2 – Formulari i Dërgesës

- 2.1 Të gjithë shërbimet e Operatorit ofrohen bazuar në formularin shoqërues të dërgesës që Operatori ka publikuar dhe i cili i bashkëngjitet këtyre Kushteve (këtu e në vijim referuar si “Formulari i Dërgesës”).
- 2.2 Formulari i Dërgesës dhe përmbajtja e tij është e pandryshueshme dhe e panegociueshme. Në rastin kur Operatori do të ndryshojë Formularin e Dërgesës, variantin e ndryshuar do ta publikojë në faqen e tij zyrtare në internet (webpage).link
- 2.3 Dërguesi pranon në mënyrë të përvokueshme se Formulari i Dërgesës plotësohet nga ai personalisht ose nga Operatori për llogari të Dërguesit dhe me të dhënat e paraqitura nga ky i fundit.
- 2.4 Dërguesi garanton që për çdo objekt që cilësohet në faqen e parë, ky përshkruhet saktësisht dhe në përputhje me ligjin, të dhënat dhe adresa e Marrësit. –Objekti që dërgohet duhet të jetë i ambalazhuar në atë mënyrë që të sigurohet dërgimi i sigurtë i tij.
- 2.5 Dërguesi do të paguajë të gjitha shpenzimet e mundshme shtesë, që mund të rezultojnë gjatë dërgimit, kthimit ose magazinimit të objekteve.
- 2.6 Dërguesi deklaron dhe pranon në mënyrë të përvokueshme se është pronar, posedues ose përfaqësues i pronarit apo i poseduesit të objekteve që transportohen, të cilat përshkruhen në faqen e parë të Formularit të Dërgesës. Gjithashtu Dërguesi deklaron se Operatori nuk mban dhe nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi të çfarëdolloji qoftë, në lidhje me ndonjë pretendim nga palë të treta në lidhje me titullin e pronësisë apo posedimit të këtyre objekteve që transportohen.
- 2.7 Gjithashtu, Dërguesi deklaron se me nënshkrimin e Formularit të Dërgesës pranon kushtet e transportit të Operatorit.

Neni 3 – Të Drejtat e Operatorit

- 3.1 Operatori ka të drejtën, por jo detyrimin të kontrollojë objektin, të cilin merr përsipër ta transportojë/ dërgojë/ dorëzojë.
- 3.2 Operatori, gjithashtu, ka të drejtë të mos e përmbushë detyrimin e dërgesës nëse objekti që transportohet ka shenja ose përmbajtje të ndaluar ose të dhëna të pamjaftueshme të Marrësit apo pasakësi në adresën e tij.



3.3 Operatori ka të drejtë të mbajë ose të mos dorëzojë objektin që transporton, me qëllim sigurimin e shpenzimeve të transportit (shpenzimet e ngarkimit, etj) deri sa këto të paguhen plotësisht nga Dërguesi apo Marrësi, sipas rastit.

3.4 Operatori bën çdo përpjekje dhe ndërmerr çdo veprim për të arritur dorëzimin e objekteve të Dërguesit tek Marrësi, por, në asnjë rast nuk mban përgjegjësi për vonesën e marrjes, transportimit ose dorëzimit të çdo objekti apo për çfarëdolloj humbjeje, dëmtimi, dorëzimi të metë apo mos dorëzimi që i detyrohet shkaqeve të mëposhtme:

- a) Për shkak të ngjarjeve të papritura që ndodhin objektivisht jashtë mundësive njerëzore (aksident, kushte të keqija atmosferike, vonesë e mjeteve të transportit etj.)
- b) Për shkak të veprimeve neglizhuese ose udhëzimeve të gabuara të Dërguesit ose të Marrësit apo personave të tretë që kanë interes nga dërgesa konkrete.
- c) Për shkak të përmbajtjes së dërgesës së cilës mund t'i shkaktohet dëmtim i veçantë, ndryshim ose shkatërrim.

Neni 4 – Pagesa e Shërbimeve

4.1 Operatori kryen dërgesat duke debituar Marrësin, në rastin kur ky i fundit nuk e pranon dërgesën. Nëse për çfarëdolloj arsyeje Marrësi nuk pranon të paguajë tarifën përkatëse atëherë detyrimi për pagimin e tyre i transferohet plotësisht Dërguesit.

4.2 Operatori ofron dy opsione për pagesën e tarifave të veta:

1. "Parapagimit për dërgesën e porositur" -Behet nepermjet pageses me karte ne emer te kompanise postare
2. "Pagesës në momentin e dorëzimit" -Dakortesimi me derguesin per menyren e pageses,pra ne kete rast marresi paguan ne momentin e marrjes se pakos.(COD-cash on delivery)

Duke marrë porosi dhe në formë jo të shkruar (me telefon ose mjete të tjera komunikimi). Në këto raste porositësi ka të drejtat dhe detyrimet e "dërguesit" të përshkruar në formular.

Neni 5 – Limitet e Përgjegjësisë së Operatorit

Përgjegjësia e Operatorit për çfarëdo humbje ose dëmtim të objektit të dërgesës (dokument ose mall), kufizohet si me poshte:



- a) deri në shumën 3,000 Lekë (tremijë) për dokumente dhe deri në shumën 10,000 Lekë (dhjetëmijë) për mallra,
- b) në shumën reale të humbjes ose dëmit që paguhet për dokumentet ose objektet e siguruar siç përcaktohet në nenin 6 këtu më poshtë,
- c) në vlerën reale të dokumenteve ose objekteve, pa u marrë parasysh përdorimi tregtar ose vlera e veçantë e tyre për Dërguesin, Marrësin ose personin e tretë. Sa më sipër është e vlefshme edhe për dërgesat me vlerë të deklaruar kur janë të siguruar. Çdo dërgesë ndërkombëtare udhëhiqet nga kushtet dhe kufizimet e konventave ndërkombëtare CMR, Varshavës, COTIF-CIM që janë në fuqi.
- d) Për tejkalimin e afatit të dorëzimit të objekteve postare të regjistruara dhe siguruar, brenda vendit, përtej normave të parashikuara, 500 Lekë (pesëqind) për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 5,000 Lekë (pesëmijë).

Neni 6 – Sigurimi i Dërgesave

Më dëshirë të Dërguesit, kryerja e dërgesave të tij mbulohet me siguracion nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve më të cilën bashkëpunon Operatori. Në rast humbjeje, vjedhjeje ose shkatërrimi të objektit që transportohet, vlera e të cilit e kapërcen shumën prej 10,000 Lekë (dhjetëmijë), pretendimi për zhdëmtim mbi këtë shumë lind vetëm në rast se objekti që transportohet është me vlerë të deklaruar dhe i siguruar për atë vlerë.

Neni 7 – Objektet e ndaluara

Operatori nuk merr përsipër dërgimin dhe transportimin e objekteve postare kur ky transport është në kundërshtim me ligjin ose ka të bëjë me objekte që nuk i pranon për dërgim IATA (International Air Transport Association). Në çdo rast dhe për hir të qartësisë, Operatori nuk merr përsipër kryerjen e transportit të parave apo të vlerave monetare në çfarëdolloj forme apo lloji qofshin.

Neni 8 – Afatet e Shërbimeve

8.1 Dorëzimi i objekteve postare për rrethin e Tiranës:

- Objektet e tërhequra deri në orën 13.00, dorëzohen tek Marrësi 2-6 ore të asaj dite.



- Objektet e terhequra pas ores 13.00 dorëzohen ditën e nesërme deri në orën 12.00 (paradite). (Kjo në varësi të orarit të disponibilitetit të Marrësit të dërgesës).
- Në rastet kur Marrësi i dërgesës është disponibel gjatë gjithë ditës, dorëzimi është i mundur deri në orën 19.00.
- Për objekte postare për të cilat ka probleme me adresën e Marrësit, ose për arsye të ndryshme nuk mundësohet dorëzimi, behen tre tentativa dorëzimi.

8.2 Dorëzimi i objekteve postare për rrethet:

- Behet gjatë orarit të punës së ditës së nesërme të grumbullimit të tyre, (17-24 ore nga grumbullimi)
- Për objekte postare për të cilat ka probleme me adresën e Marrësit, ose për arsye të ndryshme nuk mundësohet dorëzimi, behen tre tentativa dorëzimi.

8.3 Afatet e lartpërmendura mund të variojnë në varësi të sasisë së objekteve për shpërndarje.

Neni 9 – Ankimi ndaj shërbimeve postare dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

9.1 Çdo përdorues i shërbimit postar mund të paraqesë ankim me shkrim brenda 30 ditëve nga kryerja e shërbimit nga Operatori ose nga data kur Operatori duhej ta kishte kryer shërbimin objekt ankimi.

9.2 Për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje mes Dërguesit dhe/ose Marrësit dhe Operatorit, përgjegjëse do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dorëzimi i objekteve postare për Tiranën:

- Objektet e terhequra deri në orën 13.00, dorëzohen në destinacion 2-6 ore të ditës në vijim.
- Objektet e terhequra mbas orës 13.00 dorëzohen ditën e nesërme deri në orën 12.00 të mëngjesit. (Kjo në varësi të orarit të marrësit të objektit)
- Për objektet postare, kur marrësi i zarfit është disponibel gjatë gjithë ditës, mundësojmë dorëzimin deri në orën 19.00.



- Per objekte postare qe kane probleme me adresen e marresit, ose per aresye te ndryshme nuk mundesohet dorezimi, behen tre tentativa dorezimi.

Dorezimi i objekteve postare per rrethet:

- Behet gjate orarit te punes se dites se neserme te grumbullimit te tyre, (17-24 ose nga grumbullimi)
- Per objekte postare qe kane probleme me adresen e marresit, ose per aresye te ndryshme nuk mundesohet dorezimi, behen tre tentativa dorezimi.

PS.Afatet kohore te dorezimit te objekteve jane ne varesi te sasise se objekteve per shperndarje.

Administratori:

